



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT TË KOMPANISË RAJONALE TË
UJËSJELLËSIT HIDROREGJIONI JUGOR SH.A PRIZREN
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren*, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme *Arvita Zyferi*, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Liridona Berisha-Kelmendi*, dhe anëtarët *Ernes Beka* dhe *Jetmira Isufi*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Enver Boqolli*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	13
4 Qeverisja e mirë.....	24
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	26
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	31
Shtojca II: Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit	34

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Hidroregjioni Jugor sh.a Prizren (më tutje Hidroregjioni Jugor) për vitin 2018, i cili e përfshinë Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 13/11/2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Hidroregjionit Jugor.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


Opinion i kundërt

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018, nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Për më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Kryesuesi i Bordit nuk është pajtuar me disa nga gjetjet dhe konkluzionet e auditimit. Komentet e Kryesuesit të Bordit për çështjet për të cilat nuk jemi pajtuar, janë dhënë në detaje në Shtojcën II.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Ndërmarrjes Publike KRU Hidroregjioni Jugor gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase;
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është e bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Hidroregjionit Jugor, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (më tutje AP).

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit si dhe janë dhënë rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e përgatitur dhe nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit (ZKFTH) dhe Kryeshefi Ekzekutiv (KE) të cilat janë dorëzuar për miratim në Bordin e Drejtorëve (BD).

Miratimi i PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë aksionarit dhe publikut të gjerë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinion i kundërt

Kemi audituar PFV-të e Hidroregjionit Jugor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhjes së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet si dhe përmbledhjen e procedurave kontabël dhe shënimeve tjera shpjeguese. Sipas opinionit tonë, për shkak të çështjeve të përshkruar në paragrafin Baza për Opinion të Kundërt, pasqyrat vjetore financiare nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale të Hidroregjionit Jugor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës. Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit akrual të kontabilitetit, Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

Baza për opinion të kundërt

Ne kemi krijuar bazën për opinionin të kundërt, për arsyet e përmendura në vijim:

- Sipas SNK 16, rivlerësimi i pasurisë jo qarkulluese duhet të bëhet njëherë në 3 deri 5 vite. Vlera e pasurive jo qarkulluese (toka, objekte ndërtimore, pajisje & makineri, vegla & inventar dhe mjete transportuese) sipas PFV ishte 19,504,833€ për të cilat kompania nuk kishte bërë rivlerësimin e tyre që nga viti 2007. Andaj ne nuk ishim më gjendje që të konstatojmë nëse kjo vlerë është e saktë, apo e mbi/nënvlerësuar.
- Rezerva për aksionet vetjake e prezantuar në Pasqyrën e pozitës financiare ishte 14,574,432€. Kjo vlerë, krahasuar me vitin paraprak ishte zvogëluar duke debituar për 400,292€, si pasojë e

zhvlerësimin për mjetet e rivlerësuara të vitit 2007. Si rrjedhojë, kjo shumë ka ndikuar në mbivlerësimin e të hyrave tjera afariste në pasqyrën e të ardhurave duke e ndikuar edhe rezultatin financiar të Kompanisë. Po ashtu, për të njëjtën vlerë të hyrat nga donacionet në pasqyrën e rrjedhës së parasë janë mbivlerësuar.

- Sipas SNK 7, pasqyra e rrjedhës së parasë raporton fluksin e mjeteve monetare gjatë periudhës duke i klasifikuar në aktivitete operative, investuese dhe financuese. Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative dhe financuese nuk paraqesin pamje të drejtë:
 - Llogaritë e arkëtueshme tregtare gjatë vitit ishin zvogëluar për 98,449€, ndërsa në rrjedhën e parasë sipas aktiviteteve operative ishte prezantuar si rritje e kërkesave afatshkurtra për (231,553€), duke u mbivlerësuar për 133,104€;
 - Llogaritë e pagueshme tregtare gjatë vitit ishin rritur në vlerë prej 835,117€, mirëpo në rrjedhën e parasë sipas aktiviteteve operative ishin prezantuar gabimisht në vlerë prej (843,238€), duke u mbivlerësuar për 8,121€;
 - Inventari (stoqet) gjatë vitit ishin rritur për 201,831€, ndërsa në rrjedhën e parasë sipas aktiviteteve operative në vend se të prezantohej kjo vlerë si zvogëlim i parasë ishte prezantuar si rritje e parasë, duke u mbivlerësuar për 403,662€;
 - Të rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese ishin prezantuar gabimisht të hyrat të cilat kompania i mbledh nga aktiviteti primar i saj, duke i mbivlerësuar kështu aktivitetet financuese për 1,568,538€.
- Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të arkëtueshme tjera njihen në vlerën reale. Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në pasqyrat financiare vjetore krahasuar me shënimet kontabël ishin nënvlerësuar për 94,430€. Gjithashtu, kompania nuk ka arritur të përcjell nëntë (9) letër konfirmime në vlerë prej 32,204€, me arsyetimin se konsumatori nuk gjendet në Kosovë si dhe ndërmarrjet Vllaznimi dhe N.N Unimont që ishin faturuar nuk ushtrojnë veprimtarinë më. Këto NP janë në proces të likuidimit dhe pas përfundimit të këtij procesi Kompania pritet të paraqitet si pretendente për inkasimin e borxheve në Agjensionin Kosovar të Privatizimit.
- SNK 1, Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të pagueshmet tjera njihen në vlerën reale. Llogaritë e pagueshme të prezantuara në pasqyrën e pozitës financiare nuk prezantojnë një gjendje të saktë të detyrimeve ndaj furnitorëve. Gjatë procesit të verifikimit tek furnitorët nëse përputhen borxhet e tyre me shënimet në kontabilitetin e kompanisë nga konfirmimet e pranuar, në pesë (5) raste vlera e konfirmimeve të pranuar ishte 1,152,292€ për të njëjtët furnitor që në kontabilitet janë prezantuar 1,221,568€, duke i mbivlerësuar borxhet për 69,276€. Për më tepër, në 1 (një) rast është nënvlerësuar obligimi ndaj furnitorit në vlerë 204€. Kjo ka ndodhur për shkak të mos harmonizimit të kartelave në mes të furnitorëve dhe kompanisë.
- Shënimet shpjeguese nuk japin informacione shpjeguese të plota dhe të sakta, për disa nga zërat e prezantuara në pasqyrat financiare, për më shumë detaje shih nënkapitullin 3.6.

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Ndërmarrjeve Publike (më tutje

NP) në Kosovë, ZKA është i pavarur nga Hidroregjioni Jugor dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kundërt.

Çështjet kyçe të auditimit

Hidroregjioni Jugor kishte përgatitur strategji për zvogëlimin e humbjeve të ujit për vitet 2018-2022. Edhe për kundër përpjekjeve gjatë vitit 2018, uji i pa faturuar apo siç quhet ndryshe humbja e ujit ishte 57%, përderisa në vitin 2017 humbja e ujit në këtë kompani ishte 58%. Humbjet e ujit sipas raporteve të ARRU-së¹ janë për shkak të humbjeve teknike (rrjedhjet), humbjet komerciale (lidhjet ilegale, pasaktësitë gjatë leximit të ujëmatësve, faturimi pa ujëmatës, etj.) dhe një sasi e humbjeve të autorizuara (objektet e kultit, zjarrfikësit, fontanat publike, etj.).

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Menaxhmenti i Hidroregjionit Jugor është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në bazë të parimit akruar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime) dhe Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të NP-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është

¹ ARRU- Autoriteti Rregullativ për Shërbimet e Ujit

relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

NP kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiare dhe Auditim;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L- 42 për Prokurimin Publik (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit;
- Kërkesat e Udhëzimit nr. 2/2013/MF për Strukturën dhe Përmbajtjen e Raporteve Financiare Vjetore; dhe
- Nga NP-të, po ashtu kërkohet të përmbushin edhe kërkesat në vijim:
 - Statutin e NP-së;
 - Planin e Biznesit;
 - Raportet tremujore;
 - Raportin vjetor;
 - Raportin nga matja e kënaqshmërisë së konsumatorëve; dhe
 - Draft planin dhe planin përfundimtar të prokurimit me kohë.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, miratimi i bërë nga KE dhe ZKFTH, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Bordin e Drejtorëve, mund të konsiderohet i pasaktë për shkak se gjatë auditimit janë identifikuar gabime materiale dhe çështje tjera të përmendura tek baza për opinion të kundërt.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, kemi identifikuar mos-pajtueshmërinë si në vijim:

- Ekzistojnë mospërputhje në mes të shënimeve analitike të të hyrave dhe faturimit ku këto pasaktësi janë prezantuar edhe në raportet tremujore. Kjo për shkak se në faturimet mujore nuk janë të përfshira edhe tarifat e kyçjeve. Për vitin 2018 diferenca është 9,884€.
- Plani i biznesit për vitin 2018-2020 i përmban synimet afariste dhe financiare të cilat kompania synon ti arrijë gjatë vitit 2018 si dhe qasjen për realizimin e këtyre synimeve. Mirëpo, plani nuk përmban afatet kohore për realizimin e këtyre synimeve.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi B1 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se rivlerësimi i pasurisë jo qarkulluese kryhet së paku njëherë në 3 deri 5 vite dhe në PFV-të e kompanisë paraqitet vlera e drejtë e pasurive në përputhje me SNK 16.

Rekomandimi A1 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që janë bërë korrigjimet e nevojshme, që pasqyrat financiare të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Rekomandimi A2 Kryesuesi i Bordit të sigurojë se zërat përbërës të pasqyrës së rrjedhës së parasë janë prezantuar drejtë nëpër aktivitetet përkatëse operative, investuese dhe financuese.

Rekomandimi A3 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë bërë të gjitha veprimet për forcimin e kontroleve të brendshme që të bëhet harmonizimi i duhur i shënimeve kontabël me PFV-të e kompanisë. Gjithashtu të siguroj se letër konfirmimet janë përcjellë të klientët përkatës.

Rekomandimi A4 Kryesuesi i Bordit të sigurojë se llogaritë e pagueshme prezantohen me vlerën e tyre reale në mënyrë që të shmangen pagesat e parregullta, ndërsa në rastet ku klientët konfirmojnë vlera tjera nga ato në kontabilitet të kompanisë të ndërmerren veprimet e nevojshme për harmonizimin e tyre.

Rekomandimi A5² Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar tek dhënia e Opinionit të Kundërt dhe do të merren veprimet e nevojshme për eliminimin e tyre. Gjithashtu, kryesuesi i bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD-së.

² Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në Kompaninë Publike. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e të hyrave, shpenzimeve, pasurive, detyrimeve dhe llogarive të arkëtueshme.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli, kanë të bëjë me forcimin e performancës së kompanisë që të marrë vendime më të mira, të jap shërbime më të mira dhe të japë vlerë më të mirë për paranë. Për të arritur këtë, MFK synon që menaxhmenti i Hidroregjionit Jugor të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare por edhe për të siguruar që këto vendime janë adekuate dhe në interesin më të mirë të publikut. Kjo do të thotë, të sigurohet se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur, nëpërmes përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, si personeli, pasuritë dhe buxheti sipas planit të biznesit.

Në kontekst të sistemeve financiare, nuk ka kontrole të mjaftueshme mbi njohjen e të hyrave të shtyra dhe realizimin e shpenzimeve sipas procedurave të prokurimit publik. Kjo pasi që, kompania nuk i njeh të hyrat e shtyra si dhe nuk ishte në gjendje ti identifikoj konsumatorët të cilët kanë kryer pagesat përmes bankës.

Gjithashtu, blerja e mallrave dhe shpenzimeve bëhet pa procedura të prokurimit.

Të gjitha këto janë tregues që kontrollet e brendshme në menaxhimin e kategorive të lartë cekura ishin të pamjaftueshme.

3.1 Plani i biznesit (të hyra dhe shpenzimet)

Ne i kemi shqyrtuar burimet e të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara me planin vjetor të biznesit sipas kategorive përkatëse. Kjo është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1. Tabela e të hyrave dhe shpenzimeve sipas planit vjetor për vitin 2018 (në €)

Përshkrimi	Planifikimi fillestar	Plani përfundimtar	Realizimi 2018	Realizimi 2017
Të hyrat nga shitja	4,690,473	4,741,213	4,294,314	4,171,108
Të hyrat nga shërbimet tjera	108,176	16,685	72,813	89,433
Të hyrat e shtyra(grantet)	1,449,770	1,449,770	875,831	1,164,930
Gjithsej të hyrat	6,248,419	6,207,668	5,242,958	5,425,471
Shpenzimet për paga	2,317,542	2,043,227	2,070,066	1,995,391
Shpenzimet operative ³	3,919,221	3,598,402	1,568,829	1,933,162
Shpenzimet e zhvlerësimit	1,331,635	1,331,635	1,239,299	1,254,423
Provizionet-Borxhet e këqija	597,000	597,000	330,001	212,000
Gjithsej Shpenzimet	8,165,398	7,570,264	5,208,195	5,394,976

Shpjegimet rreth ndryshimeve në planifikimin e të hyrave dhe shpenzimeve janë dhënë si në vijim:

- Planifikimi përfundimtar i të hyrave nga shitjet/shërbimet ishte më i lartë sesa realizimi për 964,710€ respektivisht 15%, kjo për shkak që disa investime të planifikuara për zonat rurale nga investitorët nuk ishin realizuar.
- Planifikimi përfundimtar i shpenzimeve ishte më i lartë se shpenzimet për 2,362,069€ respektivisht 31%, kjo për shkak që këto shpenzime kanë qenë të lidhura edhe me investimet të cilat nuk kanë ndodhur.

³ Shpenzimet operative përfshijnë: shpenzimet për mirëmbajtje, derivate, të konsulencës, të sigurimit, të qirasë, të telefonit, administrative dhe komunal.

3.2 Pasqyra e pozitës financiare

Ne kemi bërë auditimin e pasqyrës së pozitës financiare, duke i testuar edhe gjendjet e llogarive, por edhe transaksionet e ndodhura gjatë vitit në kuadër të këtyre llogarive. Përveç ekzaminimeve të gjendjes kontabël të llogarive, ne kemi trajtuar edhe aspektet e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret dhe kemi dhënë rekomandimet si më poshtë.

Tabela 2: Pasqyra e pozitës financiare i Hidroregjioni Jugor më 31 dhjetor 2018 (në €)

Pasuritë	Viti 2018	Viti 2017
Patentat, licencat, markat tregtare, softueri dhe të drejtat	121,835	130,589
Toka	1,585,150	1,585,150
Objektet ndërtimore	2,048,191	2,236,964
Pajisjet dhe makineritë	9,661,212	10,456,107
Investimet në vijim	6,010,890	3,310,643
Veglat, inventari i repartit dhe mjetet transportuese	199,481	151,929
Stoqet	564,458	362,626
Llogaritë e arkëtueshme	2,901,077	2,999,526
Pasuritë tjera financiare jo qarkulluese	6,114	3,139
Paraja në bankë dhe arkë	740,515	436,467
Gjithsej Pasuritë	23,838,832	21,682,141
Ekuiteti		
Kapitali themelor	25,000	25,000
Kapitali rezerve	14,574,432	14,974,725
Fitimet/Humbjet e mbajtura	(6,825,099)	(6,734,485)
Fitimet/Humbjet e vitit	34,762	30,493
Detyrimet		
Detyrimet afatgjata	11,459,781	9,659,690
Llogaritë e pagueshme tregtare	2,723,362	1,888,653
Llogarit tjera të pagueshme ⁴	47,556	20,369
Obligimet për tatime dhe kontribute	1,799,037	1,817,696
Gjithsejtë Detyrimet dhe Ekuiteti	23,838,832	21,682,141

⁴ Këtu janë të përfshira: Obligimet për hua, depozita dhe të ngjashme, obligimet afatshkurtra për avancë dhe obligimet ndaj të punësuarve.

Hidroregjioni Jugor gjatë vitit 2018 dhe deri në këtë fazë të hartimit të raportit tonë të auditimit për PFV 2018, ka qenë në kontrollë tatimore për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), nga ana e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) pasi që ishte ngarkuar me obligime shtesë nga ATK dhe kishte parashtruar ankesë në departamentin e ankesave pranë ATK-së e cila e kishte aprovuar si të bazuar ankesën dhe tani lënda është kthyer në ri shqyrtim- ri vendosje.

Tatimet shtesë ose ndëshkimet që mund të rezultojnë pas raportit final të ATK-së, nuk mund të përcaktohen në këtë moment me ndonjë saktësi të arsyeshme dhe si rrjedhojë nuk do të shprehim opinion lidhur me këtë çështje.

Çështja A6 - Mos reflektimi i korrigjimit edhe tek periudha paraprake

Gjetja Sipas SNK 8, kërkohet që ndryshimet kontabël dhe korrigjimet e gabimeve të periudhave paraardhëse të kontabilizohen retrospektivisht. Fitimet/humbjet e bartura të prezantuara në PVF e kompanisë ishin korrigjuar për efektin e pagesës në shumën 121,107€, që ishte për shpenzimet e taksave për ujë për vitet 2012-2016, mirëpo efekti i saj nuk ishte korrigjuar edhe në periudhën paraprake në zërin e fitimet/humbjet e mbajtura. Gjithashtu nuk ishin shpalosur arsyet dhe efektet e korrigjimit në shënimet shpjeguese të PVF-ve. Kjo ka ndodhur sipas zyrtarëve të kompanisë për shkak se këtë vit Hidroregjioni Jugor ka hyrë në marrëveshje me MMPH⁵ për shlyerjen e borxheve të viteve të mëhershme.

Rreziku Reflektimi i korrigjimit të gabimeve paraprake vetëm në kolonën e vitit raportues dhe jo edhe në kolonën e vitit paraardhës në PVF, krijojnë paqartësi dhe gabime për analiza të trendëve tek zëri i korrigjuar.

Rekomandimi A6 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që korrigjimet e efekteve nga periudhat paraprake të reflektohen edhe në kolonën e vitit paraardhës e jo vetëm në atë të vitit raportues. Gjithashtu të shpalosen në shënimet shpjeguese të pasqyrave arsyet dhe efektet e korrigjimit.

⁵ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Çështja A7 - Mos njohja e të hyrave të shtyra

Gjetja Sipas SNK1, pasqyrat financiare duhet të përgatiten sipas parimit akrual. Sipas këtij parimi, të hyrat e shtyra janë të hyra të arkëtuara në avancë, dhe paraqesin detyrime që ka kompania për të kryer shërbime në të ardhmen për shkak të shumave monetare të arkëtuara paraprakisht. Gjatë auditimit ne kemi analizuar shënimet kontabël dhe kemi konstatuar se vlera që konsumatorët kanë paguar në avancë është 20,035€ dhe për këtë vlerë ishin zvogëluar llogaritë e arkëtueshme. Kjo vlerë ishte njohur si e hyrë, ndonëse ende nuk i plotëson kriteret për t'u njohur si e hyrë derisa tu ofrohet shërbimi klientëve.

Rreziku Mos njohja e të hyrave të shtyra respektivisht detyrimeve ndaj konsumatorëve bënë që kompania mos të bëjë paraqitje të drejtë të të hyrave dhe detyrimeve aktuale.

Rekomandimi A7 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurohet që zyrtarët përgjegjës të bëjnë njohjen e të hyrave pas kryerjes së shërbimeve ndaj klientëve, ndërsa paratë e pranuar në avancë njihen si detyrime ndaj klientëve, përkatësisht të hyra të shtyra.

Çështja A8 - Pranimet e parave nga klientët e pa identifikuar

Gjetja Kompania në fund të vitit 2018 në llogaritë e saj posedon 9,588€ nga pagesat e klientëve pa adresë, pagesat e panjohura në ekstrakt si dhe pagesat që bëhen gabim në llogaritë bankare të kompanisë. Këto pagesa kryhen nga klientët e saj, por për kompaninë janë të pa identifikuar dhe deri sa të gjendet konsumatori këto mbeten pezull pasi që paratë pranohen por llogaritë e arkëtueshme të klientëve përkatës nuk kreditohen për të zvogëluar borxhin e tyre.

Kjo ka ndodhur pasi që këto para edhe pse janë paguar në llogaritë bankare të kompanisë ato ishin të paidentifikuara se për cilët klient bëhet fjalë.

Rreziku Rreziku i mos identifikimit të klientëve të cilët kanë paguar bënë që kompanisë ti mbeten llogari të hapura në fund të vitit si dhe llogaritë e arkëtueshme të jenë të mbivlerësuara.

Rekomandimi A8 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurohet që të bëhet identifikimi i klientëve të cilët kanë paguar në llogaritë bankare të kompanisë, për t'i zbritur borxhet e tyre për shumat e paguara, në mënyrë që llogaritë e arkëtueshme të paraqesin një gjendje reale. Për më tepër, kryesuesi duhet të sigurohet se janë vendosur mekanizma adekuat të kontroleve të cilat ndihmojnë në identifikimin e klientëve me kohë dhe rrjedhimisht evitohet krijimi i llogarive të pa identifikuara.

3.3 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Hidroregjioni Jugor në pasqyrën vijuese ka prezantuar të gjitha llojet e të hyrave që ka krijuar gjatë vitit, shpenzimet, si dhe rezultatin financiar.

Tabela 3: Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve më 31 dhjetor 2018 (në €)

Përshkrimi	Viti 2018	Viti 2017
Të hyrat nga shitjet/shërbimet	4,294,314	4,171,108
Të hyrat nga përdorimi i produkteve, mallrave dhe shërbimeve	72,813	89,433
Të hyrat tjera afariste	875,831	1,164,930
Gjithsej të Hyrat	5,242,958	5,425,470
Pagat dhe mëditjet	2,070,066	1,995,391
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	1,239,299	1,254,423
Shpenzimet e tjera (borxhet e këqija)	330,001	212,000
Shpenzimet e tjera afariste	1,568,829	1,933,162
Gjithsej Shpenzimet	5,208,195	5,394,976
Fitimi/Humbja para tatimit	34,763	30,494
Tatimi në fitim	0	0
Fitimi/Humbja neto	34,763	30,494

Ekzaminimet tona audituese lidhur me pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kanë rezultuar me gjetjet si në vijim:

Çështja B2 - Blerja e mallrave dhe shërbimeve pa procedura të prokurimit

Gjetja

Ndërmarrjet Publike me rastin e blerjeve të mallrave dhe shërbimeve kanë për obligim që të respektojnë të gjitha procedurat e Ligjit të Prokurimit Publik (LPP).

Nga 28 pagesat e testuara ne kemi vërejtur se kompania kishte bërë blerje direkt nga operatorët ekonomik duke anashkaluar procedurat e prokurimit.

Nga analiza e kartelave të shpenzimeve të operatorëve ekonomik që janë përzgjedhur për mostrim kemi vërejtur se Ndërmarrja kishte bërë blerje të mallrave ose shërbimeve me të njëjtin operator ekonomik ku shumica prej tyre ishin bërë me para të gatshme (petty cash) me vlera nën 100€. Vlera e përgjithshme e pagesave kalon kufirin e caktuar sipas LPP-së, prandaj Autoriteti Kontraktues ishte dashur të përdor njërën nga llojet e kontratave që përcakton nenit 19 i LPP-së. Në vijim janë paraqitur rastet e identifikuara të blerjeve pa procedura të prokurimit:

- 61 pagesa për shpenzime materiale, vlera e përgjithshme e të cilave ishte 3,182€;
- 90 pagesa me tre operatorë ekonomik të ndryshëm për shpenzime të mirëmbajtjes së automjeteve, vlera e përgjithshme e të cilave ishte 5,735€;
- Pagesa e 5 (pesë) biletave të aeroplanit me vlerë 1,375€;
- 22 pagesa për furnizim me material higjienik, vlera e përgjithshme e të cilave ishte 470€;
- 14 pagesa për furnizim me pajisje, vlera e përgjithshme e të cilave ishte 1,372€; dhe
- 20 pagesa për furnizim me pjesë, vlera e përgjithshme e të cilave ishte 1,181€.

Mangësitë e identifikuar kishin ndodhur për shkak të mos funksionimit të mjaftueshëm të kontrolleve të brendshme në procesin e planifikimit dhe realizimit të blerjeve të mallrave dhe shërbimeve.

Rreziku

Blerja e mallrave dhe shërbimeve duke anashkaluar procedurat e prokurimit rrezikon që kompania të dëmtoj buxhetin dhe të mos arrij vlerën për paratë e shpenzuar si dhe ndikon në kufizim të konkurrencës.

Rekomandimi B2 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet për forcimin e kontrolleve të brendshme për të bërë një vlerësim dhe planifikim të nevojave të kompanisë dhe artikujt e ngjashëm të grupohen dhe të përdoren procedurat e prokurimit sipas kërkesave të LPP-së, duke shmangur ndarjen e blerjeve të njëjta.

3.4 Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Në Pasqyrat Vjetore Financiare të kompanisë, kapitali është prezantuar sipas kësaj strukture:

Tabela 4: Kapitali i Hidroregjionit Jugor sh.a më 31.12.2018 (në €)

Përshkrimi	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
KAPITALI		
Kapitali themeltar	25,000	25,000
Kapitali rezervë	14,574,432	14,974,725
Fitimet/Humbjet e bartura	(6,825,099)	(6,734,485)
Fitimet/Humbja e vitit aktual	34,763	30,494

Mangësitë lidhur me prezantimin e kapitalit janë prezantuar tek baza për opinion dhe për Fitimet/Humbjet e bartura tek pasqyra e pozitës financiare.

3.5 Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme

Pasqyra e rrjedhës së parasë jep të dhëna për ndryshimet në para të gatshme gjatë periudhave raportuese të paraqitura dhe klasifikon rrjedhën e parave që arrihet nëpërmjet aktiviteteve operative, investuese dhe ato financiare. Informatat rreth rrjedhës së parave të kompanisë janë të dobishme për t'i dhënë shfrytëzuesit të pasqyrave financiare një vlerësim të rrjedhës së parave.

Tabela 5: Pranimet dhe shpenzimet e parasë së gatshme (në €)

Përshkrimi	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</i>		
(Fitimi/Humbja) para tatimit	34,763	30,494
Zhvlerësimi	1,239,299	1,254,423
Te hyrat nga donacionet	(875,831)	(1,164,930)
Rritja e detyrimeve afatshkurta	(843,238)	
Zvogëlimi i stoqeve		308,207
Zvogëlimi i detyrimeve afatshkurta		85,785
Rritja e kërkesave afatshkurta	(231,553)	(60,383)
Rritja e stoqeve	201,831	
Rrjedha neto nga aktivitetet operative	(474,729)	367,811
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive</i>		
Pagesat e parasë për blerjen e pasurive jo qarkulluese, të prekshme dhe të paprekshme	(2,985,584)	(720,373)
Paratë neto nga aktivitetet investive	(2,985,584)	(2,949,826)
<i>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</i>		
Arkëtimet tjera të parasë për aktivitet financuese	1,568,538	1,675,924
Pagesa tjera të parasë për aktivitetet financuese (grantet e pranuar)	2,195,853	1,233,127
Paratë neto nga aktivitetet financuese	3,764,391	2,909,051
Rritja /zvogëlimi i parasë gjatë vitit	304,078	327,036
Paraja në fillim të vitit	436,437	109,431
Paraja në fund të vitit	740,515	436,467

Mangësitë lidhur me prezantimin e saktësisë në pasqyrën e rrjedhjes së parasë së gatshme janë prezantuar tek baza për opinion.

3.6 Trajtimi i shënimeve shpjeguese

Shënimet shpjeguese, paraqesin informacion lidhur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave kontabël, të kërkuar nga SNRF-të dhe japin informacione shtesë të cilat nuk janë paraqitur në Bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë ose pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, por janë të rëndësishme për t'i kuptuar cilëndo prej tyre.

Çështja B3 - Prezantim jo i plotë i shënimeve shpjeguese

Gjetja

Sipas SNK1, shënimet shpjeguese duhet të paraqiten në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Çdo zë duhet të referohen në mënyrë të kryqëzuar në pasqyrën e pozicionit financiar, në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, në pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe në pasqyrën e fluksit monetar.

Gjatë analizës së shënimeve shpjeguese janë identifikuar dobësitë në vijim:

- Nuk ishin shpalosur informacione për patentat, licencat, markat tregtare, softueri dhe të drejtat tjera, veglat, inventari i repartit dhe mjetet transportuese, pasuritë tjera financiare jo qarkulluese, rezervat ligjore, rezervat për aksione vetjake të prezantuara në pasqyrën e pozitës financiare, investimet në vijim;
- Gjithashtu nuk ishte shpalosur arsyeja e korigjimit të fitimit të mbajtur dhe faktorët që e kishin shkaktuar nevojën për korigjimin dhe efektet e korigjimit nuk ishin reflektuar edhe të periudha krahasuese (viti paraparak) por e gjithë vlera e korigjimit ju kishte veshur vetëm vitit raportues (2018);
- Nuk ishin shpalosur informacione për borxhet e këqija, korigjimet e bëra të prezantuara në pasqyrën e të ardhurave;
- Nuk ishin shpalosur informacione për zërat e pasqyrës së rrjedhës së parasë;
- Nuk ishin shpalosur informacione për pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet;
- Nuk ishin shpalosur informata të sakta për zërat e llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme;
- Nuk ishin shpalosur as informatat për humbjet e ujit.

Mangësitë e identifikuara më lartë, janë si rrjedhojë e kontrolleve jo efektive, si dhe kujdesit dhe konsultimit të pamjaftueshëm me SNK-të me rastin e hartimit të PFV-ve.

Rreziku Prezantimi jo i plotë dhe mangësitë e informacioneve në shënimet shpjeguese, ndikojnë në cilësinë e pasqyrave financiare, paqartësinë e shifrave të prezantuara si dhe kufizojnë përdoruesit e pasqyrave për ta kuptuar gjendjen e drejtë dhe të vërtetë të rezultateve financiare dhe afariste të kompanisë.

Rekomandimi B3 Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve, shënimet shpjeguese do të prezantojnë të gjitha informacionet e detajuara, të plota dhe të sakta për secilin zë që përmbajnë shuma të grumbulluara në cilëndo pjesë të PFV-ve. Gjithashtu kurdo që bëhet ndonjë korrigjim i periudhave paraardhëse të shpalosen arsyet dhe efektet e korrigjimit dhe kjo të reflektoj edhe në shumat e periudhës krahasuese në PFV.

4 Qeverisja e mirë

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë auditimi i brendshëm, procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja, vështruar në kuptimin e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe planifikimit strategjik, pasqyron një situatë pozitive. Kompania ka zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve si dhe ka përgatitur planin e biznesit. Kompania nuk kishte arritur ta përgatis listën e rreziqeve operative dhe financiare me të cilat kompania potencialisht mund të përballet. Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) funksionin me një anëtar. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të Hidroregjioni Jugor dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti zbatimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komision i Auditimit efektiv.

NJAB për vitin 2018 kishte planifikuar t'i kryej 14 auditime sipas planit vjetor, të cilat ishin përfunduar deri në fund të vitit , gjithashtu ishin përfunduar edhe katër (4) auditime shtesë me kërkesë të Komisionit të Auditimit.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj rreziqeve operative të identifikuara.

Çështja B4 - Kompania nuk kishte hartuar regjistrin e rreziqeve

- Gjetja** Hidroregjioni Jugor nuk ka bërë hapa konkret në drejtim të vendosjes së sistemit për menaxhimin e rreziqeve. Ndërmarrja ende nuk kishte arritur të hartoj regjistrin e rreziqeve me qëllim të identifikimit dhe zvogëlimit të tyre në nivel të pranueshëm, siç kërkohet me Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative, neni 15.3 ku theksohet se Bordi duhet t'i rishikoj rreziqet kryesore në biznes, të sigurohet që janë të vendosura, dhe t'i rishikojë në baza të rregullta në dritën e ndryshimeve dhe objektivave strategjike të kompanisë. Kjo ka ndodhur për shkak të mos vlerësimit të rëndësisë së rreziqeve dhe efektit që mund të prodhojnë menaxhimi i rreziqeve eventuale.
- Rreziku** Mos përgatitja e regjistrit të rreziqeve ndikon që menaxhmenti të mos identifikojë dhe të menaxhojë rreziqet të cilat mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të kompanisë.
- Rekomandimi B4** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ka hartuar regjistrin e rreziqeve si operative ashtu edhe financiare si mjete të cilat testojnë efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përkrahjen e objektivave të tyre të punës.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2017 të Hidroregjionit Jugor sh.a ka rezultuar në 13 rekomandime kryesore. Hidroregjioni Jugor kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, shtatë (7) rekomandime janë zbatuar, dy (2) ishin pjesërisht të zbatuara dhe katër (4) ishin të pa zbatuara ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr .	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	<p>Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë gjithëpërfshirëse për t'i përcaktuar shkaqet për kualifikim të opinionit të auditimit, dhe të merren të gjitha veprimet që çështjet që kanë ndikuar opinionin të korrigojohen dhe të mos përsëriten.</p> <p>Gjithashtu, Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë, përfshirë edhe raportet tremujore. Nënshkrimi i pasqyrave nga ZKA dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen Bordit Drejtues.</p>	<p>Kompania gjatë vitit 2018 nuk kishte bërë rivlerësimin e pasurisë. Për vitin 2019 kishte emëruar një komision i cili ende ishte në proces të rivlerësimit.</p>	Rekomandim i pa zbatuar.
2	Plani i biznesit (të hyra dhe shpenzimet)	<p>Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj hartimin e planit të biznesit duke u bazuar në mundësitë reale të kompanisë me qëllim të realizimit të synimeve afariste të sajë, dhe ndryshimet apo devijimet e mëdha nga plani fillestar të reflektohen në një plan të rishikuar.</p>	<p>Kompania këtë vite kishte arritur të bëjë një planifikim më të mirë.</p>	Rekomandim i zbatuar.
3	Bilanci i gjendjes (Pasqyra e pozitës financiare)	<p>Kryesuesi i Bordit duhet që brenda një afatit sa më të shkurtër të hartoj një rregullore të brendshme mbi menaxhimin e pasurive jo qarkulluese, ku do të përshkruheshin të gjitha procedurat për përdorimin e pasurive (të drejtat dhe përgjegjësitë e stafit).</p>	<p>Kompania kishte hartuar rregulloren e brendshme për menaxhimin e pasurive jo qarkulluese.</p>	Rekomandim i zbatuar.
4	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	<p>Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë marrë të gjitha veprimet për forcimin e kontrolleve të brendshme për të bërë një vlerësim dhe planifikim të nevojave të kompanisë dhe artikujt e ngjashëm të grupohen dhe të përdoren procedurat e prokurimit sipas kërkesave të LPP-së, duke shmangur</p>	<p>Gjatë testimit të mostrave ne kemi hasur në të gjeturat e njëjta me vitin e kaluar.</p>	Rekomandim i pa zbatuar.

		ndarjen e blerjeve të njëjta në disa sosh.		
5.	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë konstatuar të gjithë shkaktaret e humbjeve të ujit dhe të marrë masat e duhura për zvogëlimin e tyre duke e përmirësuar raportin në mes të prodhim dhe faturimit, duke i zvogëluar humbjet dhe përmirësuar situatën financiare të kompanisë.	Kompania kishte përpiluar strategjinë për zvogëlimin e humbjeve të ujit, mirëpo gjendja ka përmirësim vetëm 1 % nga viti i kaluar.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
6.	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se me rastin e pensionimit të punëtorëve, tri pagat duhet të iu paguhen sipas pagës bruto të kontratës për tre muajt e fundit pa përfshire shtesat tjera.	Kjo vërehet nga testimi i mostrës për përlogaritjet e pagesës me rastin e pensionimit.	Rekomandim i zbatuar.
7.	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që kurdoherë dhe për çfarëdo pozita të përfill kërkesat ligjore për të ofruar konkurrencë dhe transparencë me qëllim të përzgjedhjes së punëtorëve adekuat që ofrojnë kualitet dhe performancë të mirë për punën dhe detyrat e kërkuara.	Kjo vërehet nga mostrat që kemi trajtuar për rekrutimet e reja.	Rekomandim i zbatuar.
8.	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet t'i shqyrtoj arsytet për gabimet e identifikuar si në leximin e orëmatësve të ujit ashtu edhe në procedimin e faturimeve dhe të marrë masa konkrete që gabimet e tilla të evitohen.	Kompania këtë vite, faturat i ka tatuar ashtu si duhet.	Rekomandim i zbatuar.
9.	Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që përderisa ka para të gatshme në dispozicion të bëjë pagesat e obligimeve për t'ju shmangur mundësive për ndëshkime dhe shpenzimeve shtesë.	Kompania gjatë vitit 2018 i kishte menaxhuar paratë e gatshme ma mirë për shlyerjen e obligimeve ndaj palëve të treta.	Rekomandim i zbatuar.
10.	Trajtimi i shënimeve shpjeguese	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve janë prezantuar në shënimet shpjeguese të gjitha informacionet për secilin zë të pasqyrave financiare që ka nevojë të shpaloset, dhe informacionet tjera që kërkohen të prezantohen në PVF.	Gjatë përpilimit të PFV-ve ishin munduar të bëjnë disa shpalosje por ende nuk ishin të mjaftueshme.	Rekomandim i pa zbatuar.

11.	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që është përgatitur plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili i përcakton veprimet, afatet kohore dhe stafin përgjegjës dhe azhurnohet në çdo tre muaj për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve.	Kompania kishte arritur t'i zbatonte 7 rekomandime, 2 pjesërisht dhe 4 të pa zbatuara ende nga raporti i vitit të kaluar.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar.
12.	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë marrë masat e nevojshme për identifikimin e mangësive menaxheriale dhe rreziqet potenciale operative dhe financiare të kompanisë. Po ashtu, të hartoj planin e rreziqeve të mundshme, të vlerësoj ndikimin e tyre në rast se ato ndodhin, si dhe të përcaktoj masat parandaluese dhe ato vepruese si përgjigje ndaj tyre.	Kompania ende nuk kishte hartuar regjistrin e rreziqeve.	Rekomandim i pa zbatuar.
13.	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se me rastin e pranimit të faturave, kompania i protokollon secilën prej tyre para se ato të dërgohen për pagesë.	Kompania kishte vendos kontrollë tek protokollimi i faturave.	Rekomandim i zbatuar.
	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1.	PFV	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se rivlerësimi i pasurisë jo qarkulluese kryhet së paku njëherë në 3 deri 5 vite dhe në PFV-të e kompanisë paraqitet vlera e drejtë e pasurive në përputhje me SNK 16.		
2.	PFV	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që janë bërë korrigjimet e nevojshme, që Pasqyrat financiare të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.		
3.	PFV	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se zërat përbërës të pasqyrës së rrjedhës së parasë janë prezantuar drejtë nëpër aktivitetet përkatëse operative, investuese dhe financuese.		
4.	PFV	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë bërë të gjitha veprimet për forcimin e kontroleve të brendshme që të bëhet harmonizimi i duhur i shënimeve kontabël me PFV-të e kompanisë. Gjithashtu të siguroj se letër konfirmimet janë përcjellë të klientët përkatës.		
5.	PFV	Kryesuesi i Bordit të sigurojë se llogaritë e pagueshme prezantohen me vlerën e tyre reale në mënyrë që të shmangen pagesat e parregullta, ndërsa në rastet ku klientët konfirmojnë vlera tjera nga ato në kontabilitet të kompanisë të ndërmerren veprimet e nevojshme për harmonizimin e tyre.		

6.	PFV	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar tek dhënia e Opinionit të Kundërt dhe do të merren veprimet e nevojshme për eliminimin e tyre. Gjithashtu, kryesuesi i bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2019 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD-së.
7.	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se korrigjimet e efekteve nga periudhat paraprake të reflektohen edhe në kolonën e vitit paraardhës e jo vetëm në atë të vitit raportues. Gjithashtu të shpalosen në shënimet shpjeguese të pasqyrave arsyet dhe efektet e korrigjimit.
8.	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurohet që zyrtarët përgjegjës të bëjnë njohjen e të hyrave pas kryerjes së shërbimeve ndaj klientëve, ndërsa paratë e pranuar në avancë njihen si detyrime ndaj klientëve, përkatësisht të hyra të shtyra.
9.	Pasqyra e pozitës financiare	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurohet që të bëhet identifikimi i klientëve të cilët kanë paguar në llogaritë bankare të kompanisë, për t'i zbritur borxhet e tyre për shumat e paguara, në mënyrë që llogaritë e arkëtueshme të paraqesin një gjendje reale. Për më tepër, kryesuesi duhet të sigurohet se janë vendosur mekanizma adekuat të kontrolleve të cilat ndihmojnë në identifikimin e klientëve me kohë dhe rrjedhimisht evitohet krijimi i llogarive të pa identifikuara.
10.	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet për forcimin e kontrolleve të brendshme për të bërë një vlerësim dhe planifikim të nevojave të kompanisë dhe artikujt e ngjashëm të grupohen dhe të përdoren procedurat e prokurimit sipas kërkesave të LPP-së, duke shmangur ndarjen e blerjeve të njëjta.
11.	Trajtimi i shënimeve shpjeguese	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve, shënimet shpjeguese do të prezantojnë të gjitha informacionet e detajuara, të plota dhe të sakta për secilin zë që përmbajnë shumat të grumbulluara në cilëndo pjesë të PFV-ve. Gjithashtu kurdo që bëhet ndonjë korrigjim i periudhave paraardhëse të shpalosen arsyet dhe efektet e korrigjimit dhe kjo të reflektoj edhe në shumat e periudhës krahasuese në PFV.
12.	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se ka hartuar regjistrin e rreziqeve si operative ashtu edhe financiare si mjete të cilat testojnë efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përkrahjen e objektivave të tyre të punës.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Të gjeturat/ çështjet	Pajtohemi po/jo	Komentet e NP-së në rast të mospajtimit ⁶	Pikëpamjet e ZKA-së
Baza për opinion të kundërt-Pika 2.	Jo	<p>Pozicioni i shpenzimeve të vlersimit janë të paraqitura në PA Pozicioni i shpenzimeve Pika II Nr 5 në vlerë prej 1,239,299 (për më tepër shif shpallorjet, faqe 17).</p> <p>Është e saktë se janë prezentuar si të hyra tjera afariste në PA Pika I nr. 3. Në vlerë prej 875,831 si të hyra të shtyra nga donatorët si dhe është njohur si shpenzim i zhvlerësimit të aseteve të rivleresuara (shif shpallorjet f. 17).</p> <p>Ky zhvlerësim është pjesë e zhvlerësimit të tërësishëm për vitin 2018, në shumën prej 1,239,299.26 €</p> <p>Zhvlerësimi i aseteve nga mjetet donacion: 424.260,80 eu</p> <p>b. Zhvlerësimi i aseteve nga mjetet vetanake 414.746,26 eu</p> <p>c. Zhvlerësimi i aseteve nga mjetet e Rivlerësuara 400.292.20 €</p>	Kompania ka dhënë vetëm arsye të dukshme duke e pohuar gjendjen, andaj e gjetura dhe rekomandimi i auditorit qëndron.

⁶ Për korrektësi nuk kemi ndërhyrë në komentet e Hidroregjioni Jugor sh.a

<p>Baza për opinion të kundërt-Pika 3.</p>	<p>Jo</p>	<p>Jane prezentuar te pjesa e zvoglimit te rrjedhes se parase nga aktivitetet operative si rritje e kerkesave afatshkurta por me minus (-) Re. A2 ...</p> <p>Detyrimet afatshkurte PPF jane te paraqitura (4,569,955 - 3,726,717) = 843,238 Re. A2...</p> <p>Jane prezentuar te pjesa e zvoglimit te rrjedhes se parase nga aktivitetet operative si rritje e stoqeve.</p> <p>- (Sipas formularit standart te KKRF-se, ne pjesen e aktiviteve operative nuk ka kolone ku regjistrohen te hyrat te cilat kompania i mbledh nga aktiviteti primar, si edhe ne vitet e kaluar i kemi regjistruar te aktivitetet financuese.</p>	<p>Sipas SNK 7, pasqyra e rrjedhës së parësë raporton fluksin e mjeteve monetare gjatë periudhës duke i klasifikuar në aktivite operative, investuese dhe financuese. Sipas metodës indirekte, rrjedha neto monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit përcaktohet duke rregulluar fitimin ose humbjen me efektet e ndryshimeve gjatë periudhës në inventarët, në llogaritë e arkëtueshme dhe llogari të pagueshme të aktivitetit operativ.</p> <p>Kompania ka dhënë vetëm arsyetime duke e pohuar gjendjen, andaj e gjetura dhe rekomandimi i auditorit qëndron.</p>
<p>Çështja A6.</p>	<p>Jo</p>	<p>Efektet tatimore të korigjimeve të gabimeve të periudhës paraardhëse dhe rregullimet retrospektive të bëra për të zbatuar ndryshimet në politikat kontabël, kontabilizohen dhe jepet informacion në përputhje me SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat.</p> <p>Korigjimi, i cili është bere bazuar ne marrveshjen ne mes te KRU-se dhe MMPH-se, e i cili kate beje me shlyerje te borgjeve ndaj MMPH-se per vitet 2007 - 2017, prandaj korigjimi i pozicionit Te hyrat ose humbjet e bartura, është bere ne vitin fiskal 2018, njeherit bazuar edhe ne SNK 12 korigjimi ne poziconin e larte shenuar, nuk ka reflektime - efekte tatimore (per rastin auditorve iu është ofruar edhe kopja e marrveshjes).</p>	<p>SNK 8, kërkon zbatimin retrospektiv të ndryshimeve vullnetare në politikat kontabël dhe ri deklarimin retrospektiv për të korigjuar gabimet e periudhës paraardhëse. Ai heq alternativën e lejuar në versionin e mëparshëm të SNK 8:</p> <p>(a) për të përfshirë në fitimin ose humbjen e periudhës aktuale rregullimet që vijnë si rezultat i ndryshimeve në politikat kontabël ose shuma e një korigjimi/gabimi të periudhës paraardhëse; dhe</p> <p>(b) për të paraqitur të pandryshuar informacionin krahasues nga pasqyrat financiare të periudhës paraardhëse.</p> <p>Kompania ka dhënë vetëm arsyetime duke e pohuar gjendjen, andaj e gjetura dhe rekomandimi i auditorit qëndron.</p>

Çështja A7.	Jo	<p>Kompania rregullisht per çdo vit ka bere njohjen e te hyrave te shtyra dhe te prezentuara edhe ne Pasqyrat financiare.</p> <p>Gjate punes se auditorve dhe qendrimit te tyre ne kompani, ne ju kemi ofruar shenime te mjaftueshme ne lidhje me levizjet e te hyrave te shtyra.</p>	<p>Sipas SNK1, pasqyrat financiare duhet të përgatiten sipas parimit akrual. Sipas këtij parimi, të hyrat e shtyra janë të hyra të arkëtuara në avancë, dhe paraqesin detyrime që ka kompania për të kryer shërbime në të ardhmen për shkak të shumave monetare të arkëtuara paraprakisht.</p> <p>Kompania në shënimet kontabël ka të regjistruar konsumatorët të cilën kanë paguar më shumë(avans)20,035€.</p> <p>Kompania ka dhënë vetëm arsyetime duke e pohuar gjendjen, andaj e gjetura dhe rekomandimi i auditorit qëndron.</p>
Çështja B3.	Jo	<p>Informacionet për patentat, licencat, markat tregtare, softueri dhe të drejtat tjera, jane ofruar gjate auditimit.</p> <p>Eshte ofruar regjistri i te gjithë klienteve per borxhet e keqija dhe vendimi i menaxhmentit.</p> <p>Konsiderojme se janë te sakta, mirepo te rishikohet gjykimi juaj per konfirmimet.</p>	<p>Sipas SNK1, paketën e plotë të pasqyrave financiare e përbëjnë edhe shënimet, që përfshijnë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme dhe shënime të tjera shpjeguese. Gjithashtu shënimet shpjeguese duhet të paraqiten në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Çdo zë në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe në pasqyrën e fluksit monetar duhet të referohet me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese.</p> <p>Edhe përkundër faktit që të gjitha dokumentet janë ofruar gjatë auditimit, mirëpo ato nuk ishin të shpalosura në shënimet shpjeguese.</p>

			<p>Llogaritë e arkëtueshme janë të prezantuara në PFV në vlerë prej 2,901,077€ por pasi që kjo vlerë duke u bazuar nga shënimet kontabël nuk është e saktë atëherë as në shpalosje nuk është pasqyruar saktë.</p> <p>Llogaritë e pagueshme janë prezantuar dhe shpalosur në PFV 2,723,362€ por nga konfirmimet ndaj palëve të treta ka rezultuar që kjo vlerë ishte mbivlerësuar për 69,276€.</p> <p>Kompania ka dhënë vetëm arsyetime duke e pohuar gjendjen që dokumentet janë ofruar gjatë auditimit, andaj e gjetura dhe rekomandimi i auditorit qëndron.</p>
--	--	--	---